

**VENDIM**  
**Nr. 758, datë 2.12.2019**

**PËR DHËNIE TRAJTIMI TË VEÇANTË FINANCIAR Z. ALBERT CARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5/1/a, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dhënie e trajtimit të veçantë financiar mujor z. Albert Cara, në masën e trembëdhjetëfishit të pensionit social, të miratuar sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993.

2. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 nëntor 2019.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**